

VENDIM
Nr. 60, datë 13.2.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 175, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”.

b) Në paragrafin e parë të pikës 1, pas fjalëve “...mësuesit/edukatorët...” shtohen “...punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe punonjësit e tjerë jomësimorë që shërbejnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor ...”.

c) Në ndarjen me numrin rendor 15, të lidhjes nr. 1, që përmendet në pikën 2, të vendimit, emërtimi “psikolog shkolle” hiqet.

ç) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1. Struktura e pagës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësimorë në institucionet arsimore, sipas përcaktimit në pikën 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

d) Në pikat 3.a, 3.b dhe 3.ç, pas fjalëve “... e lidhjes nr. 1 ...”, shtohen “... dhe lidhjes nr. 1/1 ...”.

dh) Në fund të pikës 3.c) shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjes nr. 1/1), është 0.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 janar 2019 dhe të përballohen nga fondet e parashikuara për sistemin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

Struktura e pagës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësimore
në institucionet e arsimit parauniversitar

EM ËR TI MI /P OZ ICI ON I	PAG A MUJ ORE
	S h t e s a e p o z i c i o n i t
	S h t e s a e p o z i c i o n i t

1				
Psi ko log sh ko lle	1			4 2 3 5 0
Of ice ri sig uri sē nē ins tit uci on et e ars imi t pa rau niv ers ita r	1			4 2 3 5 0